



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



672/19
19.11.2019

PSH. nr. 672/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Nuhi Paçarizi - Kryetar z. Blerim Dina - Referues z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Ekologjia” SH.P.K - Ferizaj, kundër Njoftimit për Anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi i hapësirave publike dhe objekteve në Komunën e Gjakovës - Kontratë dy vjeçare”, me nr. prok: 632-19-6030-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Gjakovë, më datën 31.10.2019 mori këtë :

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Ekologjia” SH.P.K - Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi i hapësirave publike dhe objekteve në Komunën e Gjakovës - Kontratë dy vjeçare”, me nr. prok: 632-19-6030-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK - Gjakovë.

II. ANULOHET, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi i hapësirave publike dhe objekteve në Komunën e Gjakovës - Kontratë dy vjeçare”, me nr. prok: 632-19-6030-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK - Gjakovë, dhe lënda kthehet në **Ri-vlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “Ekologjia” SH.P.K - Ferizaj, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 13.08.2019

Data e fundit për dorëzimin e ofertave është bërë me dt: 04.09.2019

Data e hapjes së ofertave është bërë me dt: 04.09.2019

Data e njoftimit për anulim është bërë me dt: 23.09.2019

Data e kërkesës për rishqyrtim është bërë me dt: 26.09.2019

Operatori ekonomik ankues: “Ekologjia” SH.P.K - Ferizaj, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me datën: 08.10.2019 me nr. 672/19, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi i hapësirave publike dhe objekteve në Komunën e Gjakovës - Kontratë dy vjeçare”, me nr. prok: 632-19-6030-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK - Gjakovë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59, 62, të LPP-së, nenin 108A dhe nenin 44 të RrUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 11.10.2019, ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtuese profesionale në raportin e dt: 21.10.2019, lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues: “Ekologjia” SH.P.K - Ferizaj, në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të këtij aktiviteti të prokurimit, konstaton si në vijim:

OE ankues “Ekologjia - SHPK-Ferizaj”, pretendon se Komuna e Gjakovës nuk ka respektuar nenin 1 të LPP-së, sipas OE ankues. Ekspertja thekson se qëllimi i këtij neni është të sigurojnë mënyrë ma efektive, me transparente dhe me të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, duke përcaktuar kushtet rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen, andaj edhe trajtimi i OE-në anulimin e Aktivitetit të prokurimit dhe trajtimi i Operatorin ekonomik ankues, nuk është në harmoni me nenin 1 të LPP-së . Sepse OE ankues ka dorëzuar kërkesë për ri-shqyrtim në e-prokurim dhe nuk ka marrë përgjigjeje nga autoriteti në këtë rast Komuna e Gjakovës që është dashtë në afat prej 3 tre dite të ketë një përgjigjeje, kjo është në kundërshtim me LPP-në. Ekspertja konstaton se ky pretendim është i bazuar . OE ankues “Ekologjia – SHPK - Ferizaj, pretendon se Komuna e Gjakovës nuk ka respektuar nenin 7 të LPP-së, sipas OE ankues. Ekspertja thekson se qëllimi i këtij neni është trajtimi i barabartë dhe jo diskriminues i të gjithë ofertuesve dhe trajtimi si O. E. i eliminuar, operatorin ekonomik ankues, nuk është në harmoni me nenin 7 të LPP-së . Arsyeja pse pretendimi është i bazuar është sepse Autoriteti Kontraktues komuna e Gjakovës ka anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se ka ndodhur një lëshim tek para masa, Në këtë rast AK, Është dashtë të jepte një përgjigjeje se çfarë gabimi ka ndodhur, mirëpo nuk jepen detaje me tepër se çfarë gabimi ka ndodhe vete e anulon aktivitetin në fjalë. Ekspertja konstaton ky pretendim është i bazuar. OE ankues “Ekologjia – SHPK - Ferizaj” pretendon se Komuna e Gjakovës nuk ka respektuar nenin 59 të LPP-së, sipas OE ankues.

Ekspertja thekson se qëllimi i këtij neni është Ekzaminimi vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, fillimisht autoriteti kontraktues ishte i obliguar të themelojë komisionin e vlerësimit për të vlerësuar të gjithë OE në mënyrë të barabartë sipas kriterëve të paraparë në njoftim për kontratë dhe në dosje të tenderit konform nenit 59 të LPP-së. Ekspertja konstaton ky pretendim është i bazuar . OE ankues “Ekologjia – SHPK - Ferizaj”, pretendon se Komuna e Gjakovës nuk ka respektuar nenin 69 të LPP-së, sipas OE ankues . Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet: Ekspertja thekson se qëllimi i këtij neni është që kur të përmbushen njëra nga këto kushte të bëhet anulimi i aktivitetit të prokurimit si në vijim: Një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodhë në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet: Të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit, apo Para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të

demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve. Ekspertja sqaron se AK-se me rastin e anulimit do duhet të bazohet në njërën nga këto tri kriteret që i parasheh neni 62 i LPP-së. AK – së është thirrur për anulimin e aktivitetit të prokurimit në njërën nga këto 3 pika, mirëpo nuk e ka specifikuar saktë ku ka ndodhur shkelja, përveç se e ka përmendur se ka gabime teknike procedurale në para masë, pa e arsyetuar se çfarë shkelje ka ndodhur në para masë, andaj arsyetimi nuk ishte bindës . Ekspertja konstaton se ky pretendim është i bazuar. OE ankues “Ekologjia – SHPK – Ferizaj” pretendon se Komuna e Gjakovës nuk ka respektuar nenin 108A të LPP-së, sipas OE ankues. Ekspertja sqaron se bazuar në këtë nenë AK-së mund ta aprovoj apo ta refuzojë kërkesën për rishqyrtim dhe në rastin konkret AK-së nuk e ka shqyrtuar kërkesën për ri-shqyrtim, me këtë rast nuk ishte respektuar neni 108 i LPP-së, sepse AK-së ishte i obliguar të pezulloj aktivitetin e prokurimit në momentin e pranimit të kërkesës për Ri-shqyrtim dhe pas shqyrtimit të pretendimeve të nxjerr vendim lidhur me kërkesën për Ri-shqyrtim, Andaj Ekspertja konstaton se ky pretendim është i bazuar. OE ankues “Ekologjia – SHPK - Ferizaj”, pretendon se Komuna e Gjakovës pretendon se nuk ka respektuar nenin 44 të RRUOPP-it, sipas OE ankues. Ekspertja sqaron se qëllimi i këtij neni është që të përcaktohet se kur mund të ndër prehet një procedurë e prokurimit, në këtë rast ky në ndërprerjen e procedurës së prokurimit e parasheh atëherë kur plotësohen njëra nga këto kushte, AK-së është i obliguar, Në rast të vendimit të anulimit të procedurës së prokurimit që menjëherë do të përgatisë dhe do të dërgoj njoftimin tek tenderuesit/kandidatët pjesëmarrës ku paraqiten arsyet faktike dhe bazën ligjore të anulimit të tillë. AK duhet që “Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues” ta ngritë në platformë të prokurimit elektronik si dokument shtesë nëpërmjet funksionit “shtoni dokument të ri”. AK duhet që “Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues” ta bëjë të njëjtën ditë pasi që të jetë dërguar njoftimi tek tenderuesit/kandidatët pjesëmarrës dhe pas skadimit të afatit kohor për parashtrim dhe shqyrtim të ankesave, do të përgatite Njoftimin për Anulim të aktivitetit të prokurimit pavarësisht nga lloji apo vlera e parashikuar dhe njoftimin e tillë do ta publikojë në platformën e prokurimit elektronik. Ekspertja sqaron se AK-së me rastin e anulimit nuk i ka ndjekur procedurën hap pas hapi siç e ceka më lart, apo siç parashihet me nenin 44 i RRUOPP-it. AK-së nuk e ka specifikuar saktë ku ka ndodhur shkelja, përveç se e ka përmendur se ka gabime teknike procedurale në para masë, pa e arsyetuar se çfarë shkelje ka ndodhur në para masë, ekspertja konsideron ky arsyetim nuk është bindës. Andaj, Ekspertja konstaton se ky pretendim është i bazuar . Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertja shqyrtuese e prokurimit i propozon panelit shqyrtues që ankesën e lartpërmendura të operatorit ekonomik, ta Aprovojë - si TË - BAZUARË (për arsyen që u cekën të përgjigjet në secilin pretendim), dhe i rekomandon panelit shqyrtues që lënda të kthehet në Ri-vlerësim .

Operatori Ekonomik ankues përmes parashtrësës me shkrim të datës: 22.10.2019 ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti kontraktues përmes parashtrësës me shkrim të datës: 22.10.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 31.10.2019, ku morën pjesë të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesit e OE-së ankues, ndërsa përfaqësuesit AK-së nuk janë prezent ne seance edhe pse te njëjtit i kemi njoftuar ne mënyrë te rregullt te njëjtit nuk na kanë njoftuar me arsyetimin e mos prezencës se tyre ne seancë. të njëjtit me raportin e ekspertizës te datës 22.10.2019 nuk janë pajtuar, ne seance prezentë është dhe ekspertja shqyrtues.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues z. Sylejmani deklaroj: Ashtu siç kemi parashutuar ne ankese pretendimet tona ankimore qëndrojmë prapa atyre pretendimeve dhe njëherit pajtohemi plotësisht me raportin e E. Sh e cila ka rekomanduar dhe ka dhënë mendimin e saj qe lënda te kthehet në ri-vlerësim.

Gjatë prezantimit në seancë Ekspertja Shqyrtuese znj. Krasniqi deklaroj: Pas pranimit te lendes kam shqyrtuar te gjitha shkresat e lendes dhe ne raportin e datës 21.10.2019 kam dhënë mendim qe lënda te kthehet në ri-vlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së z. Sylejmani deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues te aprovoj ankesën tone si te bazuar dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se pretendimi i OE ankues se Komuna e Gjakovës nuk ka respektuar nenin 1 të LPP-së, sipas OE ankues është i bazuar për faktin se OE ankues ka dorëzuar kërkesë për ri-shqyrtim ne e- prokurim dhe nuk ka marre përgjigje nga autoriteti ne këtë rast Komuna e Gjakovës që është dashtë në afat prej 3 tre dite te ketë një përgjigje.

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues se AK nuk ka respektuar nenin 7 të LPP-së, paneli shqyrtues konstaton se Autoriteti Kontraktues- Komuna e Gjakovës ka anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se ka ndodhur një lëshim tek para masa, dhe në këtë rast AK, ka qenë dashur të jap një përgjigje se çfarë gabimi ka ndodhur, mirëpo nuk e ka dhënë, vetëm ka anuluar aktivitetin në fjalë, andaj ky pretendim ankimor i është i bazuar.

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues “Ekologjia – SHPK - Ferizaj” se Komuna e Gjakovës nuk ka respektuar nenin 59 të LPP-së, paneli shqyrtues konstaton se fillimisht autoriteti kontraktues ishte i obliguar të themeloj komisionin e vlerësimit për ti vlerësuar të gjithë OE në mënyrë të barabartë sipas kriterëve të paraparë në njoftim për kontratë dhe në dosje të tenderit konform nenit 59 të LPP-së. Andaj paneli shqyrtues konstaton se AK ka vepruar në kundërshtim me këtë nen dhe pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar.

OE ankues “Ekologjia – SHPK - Ferizaj”, pretendon se Komuna e Gjakovës nuk ka respektuar nenin 69 të LPP-së, dhe në lidhje me këtë pretendim ankimor paneli shqyrtues vlerëson se qëllimi i këtij neni është që kur të përmbushen njëra nga kushtet e parapara në këtë dispozitë ligjore atëherë duhet të bëhet anulimi i aktivitetit të prokurimit andaj paneli shqyrtues konstaton se me rastin e anulimit autoriteti kontraktues do duhet të bazohej në njërin nga tri kriteret që i parasheh neni 62 i LPP-së. AK është thirrur për anulimin e aktivitetit të prokurimit në njërin nga këto 3 pika, mirëpo nuk e ka specifikuar saktë ku ka ndodhur shkelja, përveç se e ka përmendur se ka gabime teknike procedurale në para masë, pa e arsyetuar se çfarë shkelje ka ndodhur në para masë, andaj arsyetimi nuk ishte bindës.

Pretendimi ankimor i OE ankues se AK nuk ka respektuar nenin 108A të LPP-së, është i qëndrueshëm për faktin se AK mund ta aprovoj apo ta refuzojë kërkesën për rishqyrtim dhe në rastin konkret AK nuk e ka shqyrtuar kërkesën për ri-shqyrtim, me këtë rast nuk ishte respektuar neni 108 i LPP-së, sepse AK-së ishte i obliguar të pezulloj aktivitetin e prokurimit në momentin e pranimit të kërkesës për Ri-shqyrtim dhe pas shqyrtimit të pretendimeve të nxjerr vendim lidhur me kërkesën për Ri-shqyrtim.

OE ankues “Ekologjia – SHPK - Ferizaj”, pretendon se Komuna e Gjakovës nuk ka respektuar nenin 44 të RRUOPP-it, paneli shqyrtues sqaron se AK-së me rastin e anulimit nuk i ka ndjekur procedurën siç parashihet me nenin 44 i RRUOPP-it. AK nuk e ka specifikuar saktë ku ka ndodhur shkelja, përveç se e ka përmendur se ka gabime teknike procedurale në para masë, pa e arsyetuar se çfarë shkelje ka ndodhur në para masë dhe sipas nenit të lartpërmendur AK është i obliguar, në rast të vendimit të anulimit të procedurës së prokurimit menjëherë të përgatisë dhe do të dërgoj njoftimin tek tenderuesit/kandidatët pjesëmarrës ku paraqiten arsyet faktike dhe bazën ligjore të anulimit të tillë. AK duhet që “Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues” ta ngritë në platformë të prokurimit elektronik si dokument shtesë nëpërmjet funksionit “shtoni dokument të ri”. AK duhet që “Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit

Kontraktues” ta bëjë të njëjtën ditë pasi që të jetë dërguar njoftimi tek tenderuesit/kandidatët pjesëmarrës dhe pas skadimit të afatit kohor për parashtrim dhe shqyrtim të ankesave, do të përgatite Njoftimin për Anulim të aktivitetit të prokurimit pavarësisht nga lloji apo vlera e parashikuar dhe njoftimin e tillë do ta publikojë në platformën e prokurimit elektronik dhe e gjitha kjo procedurë paneli shqyrtues konsideron se nuk është ndjekur nga AK.

Paneli shqyrtues konstaton se përfundimi i këtij aktiviteti të prokurimit nuk është bërë konform nenit 62 të LPP-së dhe konstaton se AK duhet të rivlerësojë këtë aktivitet të prokurimit andaj, konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 (AK) - KK- Gjakovë,
- 1x1 OE -"Ekologjia" SH.P.K - Ferizaj,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb-faqe të OSHP-së.